ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **NPL KASTRIOTI -25-211-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **"Furnizim me material elektrik për nevoja të NPL Kastrioti Sh.A"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Exact Pro L.L.C.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Milloshevë, Obiliq
(Adresa)

Obiliq	*15050*
(Vendi)	*(Kodi postar)*
049/620469	*-*
(Numri Telefonit)	*(Numri i Faks-it)*

Remzi Ramadani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
exactpro.llc@gmail.com
(Adresa elektronike)

L.L.C. Exact Pro OBILIQ

16.06.2025 _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës e parashtron ankesën përmes përfaqësuesit zyrtar të kompanisë.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Autoriteti Kontraktues NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A. për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material elektrik për nevoja të NPL Kastrioti Sh.A" me nr. prokurimi: NPL KASTRIOTI -25-211-1-2-1, ka publikuar këto njoftime:

1. Publikimi i Njoftimit për kontratë me datë 21.01.2025
   Procedurë e hapur
   Lloji i kontratës – Punë
   Vlera e parashikuar – 92,000.00€
   Kriteri për dhënien e kontratës : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët me poentim
   Afati i fundit për dorëzimin e tenderit me 10.02.2025
2. Njoftim Vendimi i AK-së i dt. 14.02.2025
3. Kërkesa për rishqyrtim mbi vlerësimin fillestar i dt. 19.02.2025
4. Vendimi mbi aprovimin e pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtim i dt. 21.02.2025
5. Njoftim Vendimi i AK-së për rivlerësim i dt. 21.02.2025
6. Kërkesa për rishqyrtim mbi ri-vlerësimin e parë i dt. 24.02.2025
7. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i dt. 26.02.2025 16:10
8. Ankesa në OSHP mbi ri-vlerësimin e parë i dt. 10.03.2025
9. Vendimi i PSH me nr. 2025/0169 i dt. 30.04.2025 përmes të cilit është aprovuar ankesa e OE ankues "Exact Pro L.L.C.", është anuluar vendimi për dhënien e kontratës dhe është obliguar AK që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe t'i vlerësoj dhe krahasoj tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit.
10. Njoftim Vendimi i AK-së për rivlerësimin e dytë i dt. 28.05.2025
11. Kërkesa për rishqyrtim mbi ri-vlerësimin e dytë i dt. 02.06.2025
12. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i dt. 04.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Autoriteti Kontraktues me datën 02.06.2026 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së mbi rivlerësimin e dytë, tek i cili vendim AK anulon aktivitetin e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme, pra ofertën tonë e vlerëson si të papërgjegjshme duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së. 4. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 29.05.2025 ku pastaj qasja është mundësuar me datën 30.05.2025.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.

Pas kësaj ne kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim pranë AK e dorëzuar me datë 02.06.2025 derisa përgjigja na është kthyer me datë 04.06.2025 në bazë të vendimit me të cilin AK nuk i ka marrë parasysh argumentet tona për vlerësimin kundërligjor që është bërë në lidhje me këtë AP dhe në të njëjtën kohë ka vazhduar me shkelje tjera të LPP-së si dhe legjislacionit sekondar Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022. Si rrjedhojë në i drejtohemi OSHP-së në mënyrë që të parandalojmë shkeljen e Ligjeve në fuqi nga AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Parashtruesi i ankesës, konsideron se nga ana e AK-së, NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A. vlerësimi për këtë aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim me parimet e prokurimit publik, rrjedhimisht duke shkelur dispozitat përkatëse të LPP-së Nr. 02/L-042 (verzioni i konsoliduar) si ligj material dhe legjislacionit sekondar Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, në mënyrë specifike dispozitat si më poshtë:

- **Neni 1 par. 1 dhe 2 të LPP-së**
- **Neni 7 të LPP-së**
- **Neni 52 par. 1 dhe 3 të LPP-së**
- **Neni 56 paragrafi 1.1, 1.2 dhe 3 të LPP-së**
- **Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së**
- **Neni 60 par. 1.1 të LPP-së**
- **Neni 61 të LPP-së**
- **Neni 69 të LPP-së**
- **Neni 72 të LPP-së**
- **Neni 4.1 të RrPP-së**
- **Neni 25 të RrPP-së**
- **Neni 27 të RrPP-së**
- **Neni 38 të RrPP-së**
- **Neni 40 të RrPP-së**
- **Neni 41 të RrPP-së**
- **Neni 61 të RrPP-së**
- **Dispozita nr. 9 dhe 10 të UPP-së**

Njëkohësisht AK me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje edhe të **Nenit 108/A të LPP-së**.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Historia procedurale e çështjes së aktivitetit në fjalë

1. Me datën 21 Janar 2025, **AK – "NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A."** përmes platformës publike e-prokurimi ka shpallur inicimin e aktivitetit të prokurimit me titull: **"Furnizim me material elektrik për nevoja të NPL Kastrioti Sh.A"** me nr. prokurimi: **NPL KASTRIOTI -25-211-1-2-1.**

2. Kompania jonë, pra Operatori Ekonomik **Exact Pro L.L.C.** ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit në grup me OE **Elektro AM SH.P.K.** duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Në këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar shtatë (4) oferta, të cilat janë:

Nr.	Operatori Ekonomik	Çmimi (me TVSH)
1	Liria SH.P.K.	398.69 €
2	Grup i Operatorëve Ekonomik INFINITT SH.P.K.; Offishop Group SH.P.K.	774.83 €
3	N.N.P. " NDRIQIMI "	930.00 €
4	Grup i Operatorëve Ekonomik Exact Pro L.L.C.; Elektro Am SH.P.K.	1742.95 €

3. Autoriteti Kontraktues me datën 14.02.2025 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, tek i cili vendim AK rekomandon për shpërblim me kontratë OE **Liria SH.P.K.**dhe ofertën tonë e vlerëson si tenderues të pasuksesshëm duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së.

4. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me dt. 17.02.2025 ku pastaj qasja është mundësuar me datën 18.02.2025.

Ne pastaj kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim e cila është aprovuar pjesërisht nga ana e AK-së për të kthyer lënda në rivlerësim.

5. AK gjatë rivlerësimit ka vazhduar me shkelje të njejta duke rekomanduar për shpërblim me kontratë OE e njejtë si gjatë vlerësimit fillestar ndërsa ka eliminuar OE N.N.P. " NDRIQIMI " pasi oferta e të njejtit u vlerësua si e papërgjegjshme vetëm pas kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë, poashtu oferta jonë u konsiderua e papërgjegjshme përkundër vlerësimit fillestar tek i cili oferta jonë ishte vlerësuar si e përgjegjshme.

6. Menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi ne kemi vazhduar me kërkesë për rishqyrtim e cila u refuzuar nga ana e AK-së për të vazhduar me ankesë në OSHP.

7. OSHP me anë të vendimit të dt. 30.04.2024 e aprovon kërkesën tonë si pjesërisht të bazuar dhe lëndën e kthen në rivlerësim.

Në këtë vendim OSHP aprovon të gjitha pretendimet ankimore lidhur me pretendimet ndaj OE

të rekomanduar për kontratë gjatë ri-vlerësimit të parë (tashmë i papërgjegjshëm) si dhe pretendimet në lidhje me përgjegjshmërinë e ofertës tonë.

8. Pas gjithë këtyre procedurave të cilat qëllimin e vetëm e kishin eliminimin e ofertës sonë dhe rekomandimin për shpërblim me kontratë të OE të preferuar nga ana e AK-së, me datë 28.05.2025 AK publikon vendimin që edhe pritej. Tashmë në pamundësi të rekomandimit për shpërblim me kontratë OE "të preferuar" të AK-së pasi i njëjti nuk ka bërë vazhdimin e sigurimit dhe validitetit të ofertës dhe nuk mund të klasifikohet si palë me interes material në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së, AK vazhdon me shkelje të njejta tashmë duke anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm. Menjëherë pas pranimit të vendimit mbi rivlerësimin e dytë ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare me datë 29.05.2025. Ne me dt. 30.05.2025 kemi realizuar qasjen në dokumentet e procedurës së rivlerësimit.

Pra, AK duke pasur qëllim dhe shkas të caktuar para vetes eliminimin tonë me çdo kusht, pa dhënë asnjë shpjegim dhe arsye të bazuar mbi faktet vendimtare dhe dispozitat ligjore të LPP-së shkel parimet e drejtësisë dhe arsyes njerëzore, duke abuzuar qëllimisht me detyrën zyrtare ndërmerr masa të jashtëligjshme në kundërshtim me kërkesat procedurale dhe qenësore të legjislacionit të prokurimit me qëllim të eliminimit të parashtruesit të ankesës dhe krijimit të rrethanave për të krijuar një rezultat të caktuar. Pra, me këtë AK ka vlerësuar padrejtësisht ofertën tonë si të papërgjegjshme kështu duke bërë shkelje të Nenit 7.1, Nenit 59.4 të LPP-së si dhe Nenit 40.1 të RrPP-së. Oferta jonë është e plotë dhe e saktë me të gjithë dokumentet e saj shoqëruese në përputhje me të gjitha kriteret dhe dokumentet (dëshmitë) e tenderit të përcaktuara nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit.
Në vazhdim do të ofrojmë një deklaratë të qartë, të detajuar dhe të faktuar me argumente të bazuara dhe mbështetshme për secilën nga pretendimet ankimore që do t'i parashtrojmë në këtë "Ankesë" kundrejt vendimit të AK sipas të cilave mund të vëreni shumë lehtë se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në duke mos i përfillur kërkesat që vet i ka parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë lidhur me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterit të dhënies së kontratës duke shkelur parimet bazike dhe parimet e vlerësimit të prokurimit.

Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

Pretendimet për shkelje procedurale/materiale gjatë veprimeve dhe aktvendimit të AK-së për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim

Nga ana e Sektorit të Prokurimit të AK-së, përmes vendimit të datës 04.06.2025 te e cila është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ne me një arsyetim të përgjithshëm dhe të paargumentuar me asnjë fakt dhe provë konkrete. Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së kanë ndodhur një mori shkelje procedurale dhe materiale të cilat do t'i paraqesim në vijim:
Duke pranuar vendimin e AK-së të datës 04.06.2025 lidhur me përgjigjen mbi kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga ne me datë 02.06.2025, AK gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim ka vazhduar edhe me shkelje tjera.
AK në këtë përgjigje të kërkesës për rishqyrtim thekson se ka bërë "hulumtim tregu" ndërsa duke mos theksuar se si është bërë hulumtimi i tregut dhe pse nuk është dhënë e njejta gjatë qasjes në dokumentet zyrtare. Gjatë qasjes së realizuar nga ana jonë nga ana e zyrtares së prokurimit na është thënë se ofertat e marrura janë konfidenciale dhe nuk mund të kemi qasje.
Edhe përkundër mosqasjes në këto oferta sipas përgjigjes së dhënë në pretendimin nr. 3 AK shihet se hulumtimin e tregut e ka realizuar me paramasën nga Njesia Kërkuese dhe Kontratat mirëpo të gjitha këto të bazuara nga çmimet abnormalisht të ulëta të ofruara nga OE të ndryshëm për të manipuluar me realizimin e kontratave.
Konstatimet e paraqitura në të gjitha pikat e vendimit të AK-së janë të mangëta dhe si të tilla nuk janë të bazuara dhe argumentuara me faktet vendimtare në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara nga ne, kërkesave të dosjes së tenderit dhe dispozitave ligjore të LPP-së. Prandaj, ky arsyetim i vendimit të atakuar nuk e ka vërtetuar saktë dhe drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta e dispozitave materiale të LPP-së (Neni 108/A) përfshirë edhe keqinterpretimi i tyre dhe kërkesave të dosjes së tenderit. Sepse arsyet e dhëna në vendimin e AK-së nuk janë të bazuar në baza ligjore sipas dispozitave të LPP-së dhe pjesës përbërëse të legjislacionit dytësor RRPP Nr.001/2022. Për më tepër arsyetimi i vendimit të AK-së është në kundërshtim edhe me përcaktimet e nenit 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pretendimet ankimore mbi Vendimin e AK-së rivlerësimin e dytë të datës 28.05.2025

Pretendimi i parë (I)

Autoriteti Kontraktues ofertën tonë e cilëson si të papërgjegjshme me arsyetimin se:
AK duhet të sigurohet që çmimi i kontraktuar është më i lartë se çmimi i tregut, andaj AK ka kërkuar sqarime nga OE në lidhje me çmimet e ofruara edhe pas pranimit të përgjigjes me dt.23.05.2025, OE nuk ka arrit të faktoj dhe bind AK mbi çmimet e ofruara të cilat çmime janë mbi 400% më të larta se çmimet e tregut (pas hulumtimit të tregut) andaj oferta juaj refuzohet si e pa përgjegjshme.
Këto arsyetime nuk janë të bazuara dhe nuk e pasqyrojnë realitetin dhe gjendjen faktike por si të tilla paraqesin fakte të rreme me qëllim të justifikimit të këtij vendimi i cili është në kundërshtim me parimet dhe kriteret e nenit 59, nenit 69 të LPP-së lidhur me nenin 40 paragrafi 1,2 dhe 6 të RrPP nr. 001/2022.

Së pari, AK ka theksuar se ka realizuar hulumtim të tregut ndërsa të njëjtën nuk e ka ofruar gjatë qasjes pasi që nuk ekziston. AK nuk ka realizuar asnjë hulumtim të tregut. Poashtu vlera 400% që është theksuar është vetëm një kamuflim që të jepet përshtypje se asgjë e paligjshme nuk po ndodhë që të arrihet rezultati i dëshiruar nga ana e AK-së.

Së dyti, AK me dt. 19.05.2025 ka kërkuar sqarime në lidhje me çmimet e ofruara nga ana jonë dhe ne me dt. 23.05.2025 kemi dorëzuar një sqarim detaj lidhur me këto çmime. Në këtë kërkesë për sqarime ka vlerësuar 82 pozicione si çmime të larta sipas tyre si dhe duke potencuar se janë mesatarisht 400% më të lartë se çmimi i tregut ndërsa nuk ka paraqitur asnjë hulumtim tregu dhe si janë bërë krahasimet e çmimeve për të konkluduar këtë dallim në çmim, mirëpo edhe përkundër kësaj ne kemi paraqesim një shpjegim detal lidhur me këtë çështje.

1. Ne konfirmojmë se nuk kemi paraqitur asnjë çmim abnormalisht të lartë ashtu siç është potencuar, çmimet janë ofertuar duke marrë parasysh se AK gjatë publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit në asnjë pjesë të Dosjes/kritereve nuk ka përcaktuar se sa porosi do të bëhet për këto furnizime, ndërsa ka përcaktuar vetëm vendin e dërgesës. Pra AK në rastin konkret për të gjitha këto 82 pozicione i jepet e drejta që të bëjë porosi vetëm nga një copë, andaj edhe është marrë parasysh transporti i tyre me një vlerë të caktuar që do ta paraqesim në vijim. Pra si mund të konsiderohet një çmim abnormalisht i lartë nga ana e AK-së kur nuk dihet sasia e porosisë, që rezulton se nuk dihet vlera e transportit.
2. Në asnjë nga këto 82 pozicione për të cilat AK ka aluduar se kemi të bëjmë me çmime abnormalisht të larta nuk është e përcaktuar brendi apo vendi i origjinës. Ne si ofertues serioz duke marrë parasysh se në disa prej pozicioneve paraqitet edhe periudha e garancionit, poashtu duke marrë parasysh edhe sigurimin e mirëmbajtjes ne kemi ofertuar që furnizimet e këtyre pozicioneve të bëhen nga brende të njohura të cilat posedojnë kualitet të lartë dhe të mos kemi probleme gjatë ekzekutimit të kontratës dhe periudhës së garancionit/mirëmbajtjes.
3. Duke marrë parasysh se ky aktivitet i prokurimit, kohëzgjatja e saj është 24 muaj si dhe duke marrë parasysh ndodhitë e fundit lidhur me luhatjen e çmimeve në tregun botëror të të gjitha materialeve, bazuar në të dhënat e analizave të tregut vendor dhe ndërkombëtar, si dhe në raportet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe burimeve ekonomike, pritet që çmimet e materialeve elektrike të shënojnë rritje të moderuar deri në muajin shkurt të vitit 2027. Produktet kryesore të përfshira në këtë analizë përfshijnë: kabllot elektrike, kontaktorët, kutitë elektrike, dhe produktet tjera elektrike . Ne me rastin e nënshkrimit të kontratës do të duhet të garantojmë furnizimet e tilla për një periudhë prej 24 muaj, pra është marrë parasysh edhe ky kriter.
4. Sipas kërkesës së AK-së mund të aludojmë se krahasimi i çmimeve është bërë me OE të tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit të cilët janë të papërgjegjshëm pasi kanë ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta apo manipuluese me qëllimin e vetëm që gjatë ekzekutimit

të kontratës të bëjnë furnizime vetëm të materialeve tek të cilat kanë ofertuar me çmime të larta, me një fjalë të bëjnë keqpërdorime të buxhetit të AK-së.

Kemi edhe shumë raste të gjykuara nga OSHP në lidhje me këtë çështje si vendimet me nr. 354/19, 752/19, 850/20, 1044/20, 224/22 , 306/22. Tek të gjitha këto vendime PSH e obligon AK-në që vlerësimi i ofertave të bëhet në çmim të tërësishëm dhe jo pozicione individuale në mënyrë që të bëjë konstatime nëse çmimi i ofruar është çmim i tregut.

Poashtu çmimet që kemi pranuar përputhen me çmimin që kemi vendosur me rastin e ofertimit. Ne do të paraqesim një tabelë tek e cila paraqitet shumë qartë se si është kalkuluar çmimi i ofertimit për të gjitha pozicionet, duke mos bërë dallime në pozicione dhe duke mos paraqitur çmime manipuluese. Pra, çmimin e ofertuar e kemi fituar duke llogaritur një vlerë të caktuar të transportit dhe pastaj duke e shtuar një marzhë fitimi deri 30%. Poashtu duke marrë parasysh se kjo është kontratë kornizë për një periudhë prej 24 muajsh, bazuar në të dhënat e analizave të tregut vendor dhe ndërkombëtar, si dhe në raportet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe burimeve ekonomike, pritet që çmimet e materialeve elektrike të shënojnë rritje të moderuar deri në vitin 2027. Produktet kryesore të përfshira në këtë analizë përfshijnë: kabllot elektrike, kontaktorët, kutitë elektrike, dhe produket tjera elektrike . Rritja e parashikuar për këto produkte varion nga 8% deri në 12%, në varësi të produktit dhe faktorëve të jashtëm që ndikojnë zinxhirin e furnizimit. Pra rritja mesatare e përbashkët për të gjitha këto materiale vlerësohet të jetë rreth 8-12% deri në 2027.

5. Duke u bazuar në të drejtat e vlerësimit të lirë afarist, duke pasur parasysh se legjislacioni i prokurimit në situata hamendje për AK-në parashikon edhe instrumente të sigurisë siç përcaktohet në nenin 63 (Siguria e Ekzekutimit) paragrafi 3, AK si parakusht të nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të kontratës mund të kërkojë nga OE sigurimin e ekzekutimit që do të jetë i barabartë me dëmet dhe shpenzimet që AK parashikon se mund ti ketë në rast të shkeljes së kontratës nga OE. Prandaj për të siguruar AK se ne do të ekzekutojmë çdo kërkesë nga AK - kemi vendosur çmimin tonë për të cilën edhe një herë ju sigurojmë se ne do të përmbushim këto furnizime sipas standardeve dhe çdo kërkese nga AK.
6. Sipas rendit kushtetues në Republikën e Kosovës, Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë dhe secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës. Andaj në këtë kuptim rendi kushtetues i RKS në kuadër të rregullimit ekonomik përcakton si bazike të drejtën e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë duke siguruar një mjedis të favorshëm dhe ligjor për ekonominë e tregut dhe lirinë e aktivitetit ekonomik. Pra sipas parimit kushtetues por edhe legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës autoritetet shtetërore në rastin konkret AK nuk ka të drejtë që të ndërhyjë dhe kontrollojë strategjinë dhe aftësinë konkurruese financiare me çmimet e tregut që i përcakton veprimi i ofertës dhe kërkesës në kushtet e konkurrencës, bazuar në gjykimin absolut dhe të pavarur të OE.

Së treti, sipas dispozitave procedurale dhe qenësore të LPP-së gjegjësisht nenit 59.4 të këtij ligji lidhur me nenin 41 të RrPP-së, AK është i autorizuar të bëjë vlerësimin e tenderëve në pajtim me këtë ligj, si dhe në pajtim me të gjitha dispozitat e legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj duke u bazuar në kërkesat të cilat i ka paraqitur në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Dhe në këtë kuptim kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë AK nuk ka paraqitur asnjë kërkesë lidhur me ÇMIMET REFERENTE për pjesët e tenderit (sipas paramasës dhe parallogarisë së punëve) – Çmim TAVAN që përcakton nivelin minimal dhe maksimal të çmimit dhe OE duhet të mbështeten gjatë përgaditjes së ofertave financiare dhe që AK duhet të mbështetet gjatë kalkulimit dhe vlerësimit të tenderëve që do të ju shërbenin si mjet ndihmës. Atëherë duke pasur parasysh se në dosjen e tenderit nuk janë paraqitur çmimet referente që OE duhet të mbështeten gjatë përgaditjes së ofertës financiare dhe poashtu nuk është i vendosur një min. apo max. i çmimit tavan siç është vendosur tavani i çmimit maksimum në vlerën e parashikuar të kontratës, shtrohet pyetja se mbi cilën bazë është mbështetur dhe ka vendosur AK që ta vlerësojë një "çmim të lartë" kur as nuk plotësohet kushti ligjor e as nuk e ka të përcaktuar në kushtet e pjesëmarrjes të DT.

<u>Pretendimi i dytë (II)</u>

AK ka vlerësuar padrejtësisht ofertën tonë si të papërgjegjshme me arsyetim se nuk kemi plotësuar kërkesa të cilat nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit kështu duke bërë shkelje të Nenit 52, Nenit 59.2, Nenit 59.4, Nenit 72.1, Nenit 72.2 të LPP-së si dhe Nenit 40.1 të RrPP-së. Poashtu AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 56 të LPP-së më saktësisht të paragrafit 3 ku kemi: *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.".*

<u>Pretendimi i tretë (III)</u>

AK ka bërë Shkelje të rëndë (Neni 97.o të RRPP-së) pasi me provat e mësipërme dëshmohet se kemi të bëjmë më sjellje të gabuar dhe jo profesionale të zyrtarit përgjegjës të prokurimit ndaj kompanisë sonë. Kjo pasi i njejti është i obliguar sipas Nenit 39.4 të RrPP-së të organizoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP.

<u>Pretendimi i katërt (IV)</u>

Komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59.1 të LPP-së dhe Nenit 40.1 të RRPP-së pasi të njëjtit janë të obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit, gjithnjë sipas Nenit 40.13 të RRPP-së.

AK-ja nuk e ka respektuar edhe **nenin 7** të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e

FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. **Paragrafi 1 i nenit 7** të LPP-së e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente*. Po ashtu **paragrafi 6 i nenit 7** te LPP-së e parasheh që *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të siguroj: që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe **nenin 1** të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Prandaj, faktet dhe rrethanat e lartcekura e vërtetojnë se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, sepse gjatë procedurës së vlerësimit është vendosur në dëm të tenderit/ofertës së OE ankues duke na mohuar të drejtën e ligjshme të shpërblimit me kontratë, pavarësisht faktit se kemi paraqitur tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Kjo si rrjedhojë ka sjell situatën juridike, ashtu që gjatë procesit të vlerësimit AK të vazhdoj me shkelje tjera ligjore me qëllime të hapura favorizuese të cilat veprime dyshojmë se janë ndikuar nga interesat/konsideratat tjera përtej atyre ligjore.

Andaj duke konsideruar se AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartëshënuara të LPP-së dhe akteve nënligjore, ku si pasojë e shkeljeve ka rezultuar me dëmtimin e marrjes së kontratës nga **Grup i Operatorëve Ekonomik Exact Pro L.L.C.; Elektro Am SH.P.K.** pasi jemi ofertues të përgjegjshëm dhe plotësojmë të gjitha kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktivitetit të prokurimit, kërkojmë nga AK të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë ankesë dhe duke u udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit, pavarësisë dhe paanësisë në vendimarrje, i propozojmë të merr këtë:

VENDIM

- **APROVOHET SI E BAZUAR** ankesa e OE **"Exact Pro L.L.C."**
- **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i publikuar me dt. 28.05.2025 në ueb faqe të KRPP-së, dhe lënda të kthehet në RI-VLERËSIM.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente, dhe do të kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga të gjitha palët qe kanë marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik ankues në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe ligjore, rrjedhimisht në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore do të veprojë me të gjitha mjetet ligjore të lejuara, kërkesës për kompensimin e dëmeve duke përfshirë edhe fitimin e humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*